

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I
TRAJNIMIT**

**STANDARDET
E GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË
KLASAT 10-12**

TIRANË, NËNTOR 2008

Hyrje

Standardet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë mbështeten në parimin që gjuha qëndron në themel të procesit të të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal, kulturor e letrar, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore”.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë në shkollë ndihmon nxënësit në zhvillimin e aftësive komunikative, të domosdoshme këto për të realizuar të nxënit gjatë gjithë jetës.

Mësimi i kësaj lënde të integruar mundëson formimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve, për një komunikim të përshtatshëm dhe shumëplanësh.

Fusha e gjuhës shqipe dhe e letërsisë integron mësimdhënien dhe mësimnxënien e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit.

Integrimi reflektohet tek kurrikula, mësimdhënien dhe vlerësimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë. Standardet janë parë si një e tërë, një fushë e njësuar ku, secili mbështet të tjerët dhe përmirëson nivelin e të menduarit dhe të mësuarit tek nxënësit.

Integrimi vërehet tek mësimdhënien dhe mësimnxënien e përmbajtjes dhe procesit. Idetë dhe **eksperiencat (përvojat)** e përbashkëta njerëzore, konfliktet, temat e pasqyruara në tekstet e ndryshme¹ të shkruara, të folura dhe pamore përbëjnë kontekstin për mësimdhënien e proceseve, aftësive dhe strategjive të të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të të vështruarit.

Njohuritë, aftësitë dhe strategjitë e mësuara te gjuha shqipe dhe letërsia janë të integruara përgjatë kurrikulës, duke mundësuar që nxënësit të zgjidhin probleme dhe të mendojnë në mënyrë kritike e krijuese në të gjitha lëndët e shkollës.

Në përfundim, standardet e kësaj fushe përcaktojnë se të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë në mënyrë të suksesshme në procesin e:

- të lexuarit për të zgjeruar horizontin e gjithanshëm kulturor dhe për kënaqësi estetike;
- zbulimit të pasurisë gjuhësore të shqipes, në tekste a vepra të ndryshme;
- krijimit të një vizioni të plotë për vlerën e kulturës shqiptare dhe botërore, e cila konvertohet në shije estetike dhe kulturë të sjelluri;
- analizës tekstuale, zbatuar në tekste letrare e joletrare, si dhe në vepra të plota të gjinive të ndryshme letrare, me vlera të spikatura artistike;
- vlerësimit të teksteve letrare dhe joletrare, të shkruara, të folura, elektronike dhe pamore, të cilat reflektojnë:
 - “kulme” të letërsisë shqiptare në gjini dhe periudha të ndryshme;
 - “kulme” të letërsisë botërore në gjini dhe periudha të ndryshme;
 - “kulme” të shkrimeve dokumentare;
 - një mori perspektivash individuale e komunitare dhe bëjnë lidhjet e ndërlidhjet si brenda fushës së gjuhës shqipe dhe letërsisë, ashtu edhe me fushat e tjera.

¹ Tekste të ndryshme: nënkupton tekste letrare dhe joletrare, të shkruar, të folura dhe pamore

Organizimi i Standardeve

Për fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë janë formuluar 5 standarde. Këto standarde janë pohime të përgjithshme për atë që nxënësit duhet të dinë, të kuptojnë, të jenë të aftë të bëjnë në mësimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në gjimnaz. Standardet janë të ndërthurura, prandaj ato duhet të mësohen të ndërthurura dhe jo si njësi të ndara. Fusha e gjuhës shqipe dhe e letërsisë përbëhet nga standardi i :

1. Të lexuarit
2. Të shkruarit
3. Të folurit
4. Të dëgjuarit
5. Të vështruarit

Çdo standard në këtë dokument përmban një seri linjash dhe standardesh të linjave.

Linjat janë drejtime në të cilat përmbushet standardi.

Standardi i linjës është një pohim specifik, që tregon atë që nxënësit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë në një drejtim të caktuar specifik në shkollimin e tyre. Standardet e linjës shërbejnë për të matur progresin e nxënësve drejt arritjes së standardit. Sikurse standardi i përgjithshëm, edhe standardi i linjës është përcaktuar të përmbushet deri në fund të gjimnazit. Për çdo standard linje janë vendosur një seri objektivash arritjeje, të cilat identifikojnë se çfarë duhet të demonstrojë nxënësi për të arritur standardin e linjës.

Objektivat e arritjes janë pohime të njohurive ose aftësive, që nxënësi demonstroi në përpjekjen për të arritur standardin e linjës. Objektivat e arritjes listohen për çdo linjë dhe standard linje, por ato nuk janë renditur sipas shkallës së rëndësisë. ***Objektivat shprehin gjithashtu gruptemat potenciale, që lidhen me linjën dhe standardin e linjës.***

Zbatimi i standardeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë

Veprimtaritë e përdoruesve të niveleve të ndryshme, në zbatim të standardeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, duhet të përfshijnë:

1. Përdorimin e standardeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë si kornizë për të planifikuar kurrikulën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, në nivel zyrtar dhe bazë shkolle.
2. Përdorimin e standardeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për të planifikuar treguesit e vlerësimit të arritjeve të nxënësve.
3. Përzgjedhjen e strategjive të përshtatshme të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, në mënyrë që nxënësit të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e përshkuara në standardet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

4.1 Të lexuarit

Të gjithë nxënësit zbatojnë njohuritë për tingujt, shkronjat dhe fjalët e gjuhës së shkruar, për të lexuar në mënyrë të pavarur e të rrjedhshme, si dhe për të kuptuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme.

A	Linja	Ndërgjegjësimi fonologjik
4.1.A	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit përdorin njohuritë fonologjike për të lexuar saktë fjalët.
4.1.12.A	Objektivat e linjës²	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> të respektojë strukturën fonetike të fjalës; të artikulojë fjalët e tekstit të dhënë në përputhje me njohuritë e fonetikës për strukturën fonetike të fjalës; të zbulojë se të gjitha anët tingullore të shqipes, si p.sh.: shqiptimi letrar, theksi, intonacioni, organizimet tingullore, imitimet dhe simbolizmi tingullor mund të përdoren për shprehësi.
B	Linja	Njohuritë mbi fjalën
4.1.B	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zbërthejnë fjalët e një teksti nëpërmjet analizës strukturore.
4.1.12.B	Objektivat e linjës	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> të zbulojë origjinën e fjalëve si një mjet për të kuptuar domethënien e tekstit; të zbulojë kuptimin e fjalës nëpërmjet analizës fjalëformuese; të dallojë fjalët me prejardhje të huaj; të dallojë parashtesat dhe prapashtesat me origjinë të huaj; të dallojë përdorimet e fjalëve të huaja si burime shprehësie; të interpretojë kuptimet e dyta të fjalëve si pasuri gjuhësore e shqipes brenda kontekstit; të interpretojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri gjuhësore e shqipes brenda kontekstit; të vlerësojë kuptimet e figurshme të fjalëve si pasuri e shprehjes artistike në nje tekst.
C	Linja	Rrjedhshmëria
4.1.C	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit demonstronjë aftësitë e nevojshme për të bërë një lexim të rrjedhshëm dhe të logjikshëm.

² Objektivat e kësaj linje janë kërkesa të përhershme që mësuesi duhet të kërkojë nga nxënësit, për të realizuar drejtshqiptimin e shqipes standarde.

4.1.12.C	Objektivat e linjës	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënës/i,-ja: • të lexojë rrjedhshëm (me shpejtësi, saktësi, shprehësi, kuptimësi) dhe me shqiptimin e duhur tekste të ndryshme; • të realizojë leximin shprehës në përshtatje me llojin e tekstit.
D	Linja	<ul style="list-style-type: none"> • Strategjitë e të lexuarit
4.1.D	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit përdorin strategjitë e të lexuarit për të kuptuar dhe për të marrë informacionin e duhur.
4.1.12.D	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zbulojë vlerat artistike të një vepre përmes leximit të thelluar të veprës së plotë; • të vlerësojë të veçantën e një teksti letrar ; • të identifikojë karakteristika të kompozicionit (të jashtëm dhe të brendshëm) të teksteve të ndryshme • të identifikojë karakteristika përmbajtësore të teksteve të ndryshme; • të zbatojë strategji të të lexuarit që janë efektive për të kuptuar tekste të ndryshme; • të përdorë tabela, diagrame, harta etj., për të memorizuar informacionin dhe për të monitoruar procesin e të kuptuarit; • të analizojë mënyrat në të cilat organizimi strukturor i një teksti (p.sh.: sekuenca, problemzgjdhja, krahasimi, përshkrimi, lidhja e ndërmjetme etj., mbështet ose kundërshton qëllimin a domethënien e tij); • të vlerësojë mënyrat në të cilat organizimi strukturor i një teksti (p.sh.: sekuenca, problemzgjdhja, krahasimi, përshkrimi, lidhja e ndërmjetme etj. mbështet ose kundërshton qëllimin a domethënien e tij); • të përdorë njohuritë e mëparshme, përmbajtjen dhe veçoritë organizative e grafike të teksteve të ndryshme për të bërë parashikime, për t'i rishikuar dhe për t'i verifikuar ato, gjatë dhe pas leximit; • të bëjë pyetje analizuese, sintetizuese, vlerësuese përpara, gjatë dhe pas leximit të tekstit; • t'u përgjigjet pyetjeve analizuese, sintetizuese e vlerësuese në mënyrë logjike përpara, gjatë dhe pas leximit të tekstit; • të përdorë informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime; • të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet teksteve të ndryshme në lidhje me: personazhet, temën, problemzgjdhjen, lidhjen e ndërmjetme dhe relacione të tjera; • të përdorë parafrazimin dhe aftësitë organizuese për të

		<p>përmbledhur informacionin e marrë (p.sh.: idetë, ngjarjet kryesore, detajet e rëndësishme etj.) nga tekste të llojeve të ndryshme, në një linjë të logjikshme duke ruajtur qëllimin e autorit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zbulojë elemente të stilit të autorit në një tekst a vepër letrare; • të analizojë elementet formale të një teksti dramatik: dialog, monolog, didaskali; • të analizojë stilin e autorit në tekste të ndryshme; • të vlerësojë stilin e autorit në tekste të ndryshme; • të zbulojë qëllimin e leximit të një teksti të caktuar; • të dallojë faktin, opinionin, propagandën, prirjet (anësi) dhe stereotipet në llojet e ndryshme të teksteve; • të ndjekë udhëzimet e paraqitura për qëllime të ndryshme në tekstet informative; • të zbulojë funksionet e komunikimit në tekste të ndryshme; • të ndjekë rrjedhën dhe koherencën e argumenteve për të zbuluar pozicionin e autorit në një tekst bindës; • të identifikojë pozicionin e autorit në një tekst bindës; • të krahasojë dy vepra, që janë të së njëjtës gjini, që kanë të njëjtën formë ligjërimi dhe trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar sesi autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme; • të përshkruajë teknikën që autori përdor për të mbështetur pozicionin e tij; • të vlerësojë efektivitetin e teknikave që autori përdor për të mbështetur pozicionin e tij.
E	Linja	Pasurimi i fjalorit
4.1.E	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit pasurojnë fjalorin nëpërmjet leximit të teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare.
4.1.12.E	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë njohuritë e origjinës së fjalëve si dhe të dhënat e kontekstit historik e letrar, për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të fushave të caktuara të dijes; • të përcaktojë kuptimin e fjalës së re nëpërmjet kuptimit të fjalës së origjinës; • të përdorë materiale udhëzuese (p.sh.: fjalorë, enciklopedi, internet, atlase etj.), që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme; • të vlerësojë figurshmërinë e përdorur në tekste të ndryshme, përmes burimeve gjuhësore të shprehësisë (fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikologjike); • të analizojë përdorimin e gjuhës së figurshme në tekste të ndryshme dhe vepra letrare;

		<ul style="list-style-type: none"> të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë nga i nënkuptuari për të interpretuar forcën e fjalës; të hulumtojë fjalët e shkrimeve letrare dhe joletrare për të pasuruar fjalorin; të ndërtojë fjalorin e nje teksti letrar duke përdorur modele fjalorësh të fushave të ndryshme studimi; të ndërgjegjësohet për pasurinë shprehëse të gjuhës shqipe nëpërmjet dukurive të tilla gjuhësore, si: polisemia, homonimia, onomatopetë, shprehjet frazeologjike, fjalëshpejta (kalamburet), sinonimia dhe antonimia.
F	Linja	Aftësitë e të kuptuarit të tekstit dhe reflektimi ndaj tij
4.1.F	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e domosdoshme për të kuptuar tekstin dhe për të reflektuar ndaj tij.
4.1.12.F	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të analizojë tekstin si formë e ligjërimit: poetik, tregimtar, dramatik, eseistik; të analizojë sesi teksti i një periudhe kohore të caktuar reflekton kushtet dhe ngjarjet historiko-shoqërore të kohës; të zbulojë tipare të përbashkëta dhe dalluese midis një teksti të traditës letrare dhe një shkrimi bashkëkohor, duke i vendosur në marrëdhënie krahasuese; të identifikojë koncepte letrare dhe efektet e tyre në domethënien e tekstit; të identifikojë metrin (llojin e vargut, rrokjet, skemën ritmike, strofën, rimën) në tekste poetike; të interpretojë thelbin e gjuhës së figurshme, që ndikon tek emocionet dhe perceptimi i mesazhit autorial në tekste të gjinive të ndryshme; të analizojë gjuhën e figurshme brenda një teksti; të zbulojë funksionin artistik të gjuhës së figurshme, të përdorur brenda një teksti; të zbulojë sesi përdorimi i fjalëve të autorit krijon tonin dhe atmosferën e përgjithshme të veprës; të analizojë sesi zgjedhja e fjalëve ndikon në zhvillimin e temës ose qëllimit të saj; të analizojë konflikte të natyrave të ndryshme në tekste të ndryshme; të interpretojë një vepër në drejtim të arritjes artistike gjuhësore, filozofike, shoqërore e psikologjike; të dallojë informacionin thelbësor nga ai jothelbësor; të identifikojë premisat e një argumenti; të analizojë përdorimin e referencave të besueshme; të dallojë faktin nga opinioni duke përdorur informacione

		<p>nga teksti, argumente koherente dhe këndvështrimin vetjak;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zbulojë qëndrimin e autorit ndaj “lëndës” që trajton dhe lexuesit të cilit i drejtohet përmes materialit gjuhësor që përdor në një vepër të plotë apo jo të tillë; • të arsyetojë se përzgjedhja e fjalëve dhe e fjalive në një tekst informues realizon karakterin e tij objektiv dhe jopersonal; • të arsyetojë se përzgjedhja e fjalëve dhe fjalive në një tekst bindës realizon karakterin e tij gjithëpërfshirës personal; • të bëjë dallimin ndërmjet përmbledhjes së tekstit dhe qëndrimit kritik ndaj tij; • të nxjerrë përfundime me shkrim dhe me gojë, duke u bazuar në të dhënat e marra nga tekste të ndryshme; • të transmetojë njohuri, duke përdorur skemën e komunikimit letrar: autor-vepër-lexues.
G	Linja	Kërkimi
4.1.G	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë aftësitë e domosdoshme për të përzgjedhur dhe përdorur efektivisht informacionin e marrë nga tekste të ndryshme.
4.1.12.G	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përzgjedhë burime të ndryshme informacioni, të përshtatshme për kërkime; • të vlerësojë cilësinë e informacionit të përzgjedhur nga autori i tekstit; • të krijojë materiale për një portofol (dosje) që tregon një drejtim të caktuar karriere; • të përdorë informacionin e marrë nga burime të ndryshme për një çështje të caktuar, për të ndërtuar një argument, për të nxjerrë përfundime ose për të mbajtur një qëndrim; • të vlerësojë logjikën dhe vlefshmërinë e argumenteve në dokumente publike; • të vlerësojë mënyrën si paraqiten dhe shtojnë interesin këto dokumente, në audiencë të ndryshme; • të vlerësojë shkallën në të cilën këto dokumente paraqesin qëndrimet e lexuesve; • të paraqesë punë me shkrim dhe me gojë, të cilat përmbledhin materiale të ndryshme; • të nxjerrë përfundime me shkrim dhe me gojë, duke u bazuar në të dhënat e marra nga tekste të ndryshme; • të krahasojë dy vepra, që janë të së njëjtës gjini, që kanë të njëjtën formë ligjërimi dhe trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar sesi autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme.

4.2 Të shkruarit

Të gjithë nxënësit shkruajnë me një përqendrim të qartë, organizim koherent, me të dhëna dhe detaje të mjaftueshme për një sërë audiencash, qëllimesh dhe kontekstesh.

A	Linja	Shkrimi si proces
4.2.A	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zbatojnë hapat e domosdoshëm për realizimin e një shkrimi.
4.2.12.A	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përfshihet në të gjitha hapat e procesit të të shkruarit, duke shkruar përditë e për një kohë të gjatë; • të përcaktojë temën për të cilën shkruan; • të përdorë strategji të larmishme për të planifikuar shkrimin e tij/saj; • të redaktojë shkrimin duke përmirësuar stilin, këndvështrimin, organizimin, koherencën dhe qartësinë e mendimit; • të përdorë një sistem vlerësimi për shkrimin e tij/e saj dhe shkrimin e të tjerëve; • të përdorë (të shfrytëzojë) mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve për të redaktuar përmbajtjen dhe organizimin e pjesës së shkruar; • të mbledhë informacione nga burime të ndryshme për qëllime të caktuara; • të vlerësojë cilësinë e një informacioni për ta përdorur më pas në shkrimin e tij/e saj; • të reflektojë ndaj shkrimit të tij/të saj duke vendosur objektiva për përmirësim.
B	Linja	Shkrimi si produkt
4.2.B	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit përdorin njohuritë dhe elementet e domosdoshme për të realizuar një shkrim përfundimtar si një produkt cilësor, që lexohet nga një audiencë e gjerë.
4.2.12.B	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë karakteristikat, strukturat, tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme për t'i zbatuar këto njohuri në shkrimet e veta; • të vlerësojë tekste të publikuara për origjinalitetin dhe besueshmërinë e tyre; • të skicojë një ide kryesore duke e mbrojtur atë me nënide dhe organizim cilësor;

		<ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë pjesë komplekse me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore; • të shkruajë tekste të tilla, si: përshkruese, bindëse (argumentuese), informative, shpjeguese, tregimtare, poetike dhe dramatike; • të shkruajë tekste vlerësuese (kritike); • të shkruajë një studim kërkimor që sintentizon dhe citon të dhëna, duke përdorur informacione të marra për të mbështetur shkrimin e tij/saj; • të përdorë burimet e <i>para</i> dhe të <i>dyta</i> për të paraqitur të dhëna, justifikime ose qëndrime duke cituar burimet nga librat, periodikët, burimet elektronike etj.; • të parashikojë nevojat dhe qëndrimin e lexuesit përmes strategjive të tilla, si: gjuha e përshtatshme, detaje specifike, përshkrime, shembuj, anekdota, analogji, humor etj.; • të shkruajë hyrje dhe mbyllje tërheqëse e koherente; • të përdorë grafikë të përshtatshëm për të mbështetur idenë kryesore; • të zgjedhë pjesë të shkruara nga dosja individuale për të prezantuar arritjet e tij/e saj në zhanre të ndryshme; • të shkruajë fjali të thjeshta dhe të përbëra për të shprehur mendime të caktuara; • të përdorë gjuhë të saktë, detaje specifike, përshkrime, përkufizime, shembuj, analogji; • ta shkruajë pjesën në mënyrë të tillë që të bindë lexues të ndryshëm; • të përdorë fjalor dhe forma gjuhësore për të demonstruar humor, cinizëm, sarkazëm, gjallëri; • të përdorë stil vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës; • të përdorë stil vetjak për kënaqësi estetike; • të zgjedhë fjalët e duhura për të shprehur specifikisht gjendje të ndryshme emocionale, shpirtërore etj.; • të përdorë pjesë të ndryshme të ligjëratës, të cilat krijojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit; • të përdorë rrallë, por në mënyre efektive, klishe të dhe zhargonet; • të përdorë drejt lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur fjalitë dhe paragrafët ndërmjet tyre.
D	Linja	Format e shkrimit, audiencia dhe qëllimet
4.2.D	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit kanë aftësitë e domosdoshme për të shkruar në forma të ndryshme, për një shumëllojshmëri audiencash dhe qëllimesh.
4.2.12.D	Objektivat e linjës	Nxënës/i,-ja:

		<ul style="list-style-type: none"> të përdorë strategji dhe lloje të ndryshme shkrimi për qëllime dhe audiencë të ndryshme; të shkruajë tekste të llojeve të ndryshme, të cilat: <ul style="list-style-type: none"> zhvillojnë një ide, kanë një organizim strukturor të përshatshëm me qëllimin, audiencën dhe kontekstin, përfshijnë informacionin e rëndësishëm duke përjashtuar informacionet më pak të rëndësishme, bëjnë përmbledhje me një rrjedhë logjike, mbështesin gjykimet me të dhëna të përshtatshme e thelbësore si dhe me detaje të përzgjedhura, paraqesin përfundime koherente; të vlerësojë si ndikojnë mbi audiencën elemente të tilla, si: stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajta e këndvështrimi; të interpretojë efektin e përgjithshëm të veprës tek lexuesi; të zbatojë ligjin “Për të drejtën e autorit” ndaj informacionit të përdorur në punët me shkrim; të përdorë struktura të tilla, si: lidhëzat e fjalët lidhëse, kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat ndihmojnë lexuesin përgjatë shkrimit; të shkruajë për nevoja vetjake shkrime të tilla, si: aplikime për punë, kërkesa të ndryshme, letra biznesi, aplikime për shkollë, projektpropozime etj.; të përdorë efektivisht stilin vetjak për të mbështetur qëllimin dhe për të përfshirë audiencën e një shkrimi të caktuar; të analizojë argumente deduktive dhe argumente induktive.
C	Linja	Drejtshkrimi dhe pikësimi
4.2.C	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zbatojnë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës standarde për të realizuar shkrimin e një teksti.
4.2.12.C	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë rregullat drejtshkrimore të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj; të përdorë rregullat e pikësimit të gjuhës standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj; të përdorë lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të përforcuar zhvillimin logjik të ideve; të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar ligjërimin vetjak dhe të tjerëve; të përdorë një shumëllojshmëri materialesh burimore të tilla, si: fjalor, libër gramatike, internet etj., për të qortuar punët me shkrim.

4.3 Të folurit

Të gjithë nxënësit flasin në mënyre efektive për audiencë, qëllime, situata dhe kontekste të ndryshme

A	Linja	Diskutimi
4.3.A	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë aftësitë e duhura për të marrë role të ndryshme në një diskutim.
4.3.12.A	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të mbajë një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup; • të luajë role të ndryshme në një diskutim: rolin e moderatorit, rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.; • të mbështesë një pozicion në diskutime që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha; • të modifikojë një pozicion në diskutime që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha; • të kundërshtojë një pozicion në diskutime në grupe të vogla ose të mëdha; • të marrë role drejtuese në diskutime, projekte dhe forume; • të përmbledhë përfundimet e një diskutimi; • të vlerësojë përfundimet e një diskutimi; • të respektojë kërkesën për një përmbajtje të ngjeshur duke respektuar faktorin kohë; • të marrë nismën të ndryshojë rrjedhën e një diskutimi; • të shprehë një mesazh koherent; • të përdorë përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audiencë, situata dhe kontekste të ndryshme; • të shfrytëzojë pasurinë leksikore e semantike të shqipes, për të shprehur saktë mendimet e tij/saj në diskutime në grupe të vogla e të mëdha.
B	Linja	Hetimi dhe kontributi
4.3.B	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë aftësitë për të hetuar informacionin dhe për të kontribuar në diskutime që bëhen në grupe të vogla dhe të mëdha.
4.3.12.B	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme; • të zgjerojë diskutimet duke i pasuruar dhe duke i ilustruar me mendime vetjake; • të analizojë punën në grup; • të modifikojë punën në grup; • të vlerësojë punën në grup;

		<ul style="list-style-type: none"> • të zgjedhë pjesë letrare për të zbuluar tema të ndryshme; • të zgjedhë pjesë letrare për të trajtuar tema të ndryshme; • të diskutojë pjesë letrare për të zbuluar dhe zhvilluar tema të ndryshme; • të vlerësojë në mënyrë kritike qëndrimin ose këndvështrimin e autorit; • t'u përgjigjet pyetjeve të audiencës duke dhënë sqarime, ilustrime, përkufizime dhe plotësime; • të përdorë saktë elementet verbale dhe joverbale në komunikimin gojor; • të parafrazojë komente të prezantuara me gojë nga të tjerët, për të sqaruar këndvështrimin e tyre; • të japë udhëzime për të kryer detyra specifike, për t'iu përgjigjur pyetjeve ose për të zgjidhur probleme; • të zbatojë udhëzime me gojë për të kryer detyra specifike, për t'iu përgjigjur pyetjeve ose për të zgjidhur probleme; • të marrë parasysh faktorët që ndikojnë në përbërjen e mesazhit të tij/ të saj; • të zotërojë aftësitë për të prezantuar mesazhin; • të përdorë elementet e gjuhës së gjesteve, të domosdoshme për të prezantuar mesazhin; • të marrë parasysh rolin e vlerësimit në komunikimin gojor.
C	Linja	Zgjedhja e fjalëve
4.3.C	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë aftësitë e përzgjedhjes së fjalëve në një komunikim gojor.
4.3.12.C	Objektivat e linjës	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të zgjedhë fjalët e duhura për të ruajtur tonin e përshtatshëm në diskutimet e prezantimet me gojë; • të zgjedhë fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutimet e prezantimet me gojë; • të përmirësojë zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjetet retorike.
D	Linja	Prezantimi me gojë
4.3.D	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë aftësitë e domosdoshme për të realizuar një prezantim gojor.
4.3.12.D	Objektivat e linjës	Nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të prezantojë për një shumëllojshmëri qëllimesh; • të përdorë një shumëllojshmëri strategjish organizative, të domosdoshme për një prezantim; • të demonstrojë strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor;

		<ul style="list-style-type: none"> • të respektojë faktorin kohë në prezantime me gojë; • të redaktojë drafte³ të fjalimeve në mënyrë të pavarur dhe në grupe; • të përpunojë prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën; • të vlerësojë prezantimin e tij/e saj gojor për ta përmirësuar atë.
--	--	---

4.4 Të dëgjuarit

Të gjithë nxënësit janë dëgjues aktivë në grupe formale dhe joformale, për të marrë informacion nga një shumëllojshmëri burimesh në situata të ndryshme

A	Linja	Të dëgjuarit e qëllimshëm
4.4.A	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë teknikat e domosdoshme për të realizuar procesin e të dëgjuarit të qëllimshëm.
4.4.12.A	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përqendrojë vëmendjen në mënyrë të përgjegjshme mbi folësin ose mesazhin; • të diskutojë me gojë idetë e dëgjuara; • të zgjerojë me gojë idetë e dëgjuara; • të bëjë dallimin ndërmjet retorikave gojore bindëse dhe emotive; • të mbajë shënime të tilla, që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; • të bëjë pyetje të përshtatshme, që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; • të identifikojë fjalët e reja, nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore; • të zbulojë kuptimin e fjalëve të reja, nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore; • të tregojë mënyrën sesi zgjedhja e fjalëve dhe e gjesteve zbulojnë qëllimin e folësit.
B	Linja	Të dëgjuarit për të reflektuar
4.4.B	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit zotërojnë aftësitë për të reflektuar ndaj informacionit të dëgjuar.
4.4.12.B	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojë përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit gojor; • të vlerësojë besueshmërinë e folësit;

³ draft –maket, teksti jo në variantin përfundimtar, shkrimi paraprak i një teksti .

		<ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë rastet kur përdoret propaganda ose argumenti në komunikimin gojor; • të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat; • të rikujtojë përmbajtjen e një informacioni të dëgjuar; • të zbatojë përmbajtjen e një informacioni të dëgjuar; • të ndjekë udhëzime gojore për të kryer veprime të ndryshme; • të parafrazojë informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët; • të përmbledhë informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët; • të analizojë mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose ligjërate mbështet a kundërshton domethënien ose qëllimin e saj.
--	--	---

4.5 Të vështruarit

Të gjithë nxënësit vështrojnë, vlerësojnë dhe reagojnë ndaj teksteve dhe burimeve të shkruara, jo të shkruara dhe elektronike.

A	Linja	Ndërtimi i domethënies/kuptimit nga forma të ndryshme mediatike
4.5.A	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit kanë aftësi të zbatojnë teknikat e duhura, për të ndërtuar domethënien/kuptimin nga media të ndryshme të shkruara jo të shkruara dhe elektronike.
4.5.12.A	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zgjedhë format mediatike të përshatshme për qëllimin e lexuesit; • të zbulojë veçori të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet mesazheve pamore e të shtypura; • të shpjegojë mënyrën sesi fjalët, tingujt dhe imazhet përcjellin një mesazh; • të shpjegojë si një produkt mediatik shpreh vlerën e kulturës që e prodhon; • të vlerësojë si një produkt mediatik shpreh vlerën e kulturës që e prodhon; • të vlerësojë se mesazhet mediatike janë përfaqësime të realiteteve sociale që ndryshojnë në periudha dhe vende të ndryshme; • të analizojë aspektet e tekstit të shtypur dhe elektronik që mbështesin këndvështrimin, qëndrimin ose opinionin e autorit; • të shpjegojë përdorimin e fjalëve, tingujve dhe imazheve

		<p>statike dhe të lëvizshme, në mesazhe të ndryshme mediatike, për qëllime të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> të zbulojë anë të përbashkëta dhe dalluese për mënyrën si forma të ndryshme mediatike shtjellojnë tema të njëjta.
B	Linja	Mesazhet pamore dhe verbale
4.5.B	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit kanë aftësitë e nevojshme për të vlerësuar mesazhet pamore dhe gojore.
4.5.12.B	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të analizojë media të ndryshme për stereotipe gjinore, etnike etj.; të analizojë teknika pamore në një mesazh mediatik, të përdorura për një audiencë të caktuar; të vlerësojë efektivitetin e teknikave pamore në një mesazh mediatik, të përdorura për një audiencë të caktuar; të zbulojë të përbashkëta dhe të veçanta të tri ose më shumë burimeve mediatike që ndikojnë tek mesazhi; të analizojë përparësitë dhe mangësitë e reklamimit pamor dhe gojor; të vlerësojë besueshmërinë e përmbajtjes së mesazheve të ndryshme mediatike; të krijojë rubrika vlerësimi për të gjykuar efektivitetin e mesazheve gojore dhe pamore; të zbulojë nënkuptime që fshihen pas imazheve statike (fotografi, pikturë, skulpturë etj.); të gjejë veçori të përbashkëta dhe dalluese midis formave të ndryshme mediatike, p.sh.: filmi dhe versioni i tij në libër.
C	Linja	Informimi nga mediat e ndryshme
4.5.C	Standardi i linjës	Të gjithë nxënësit kanë aftësitë e duhura për të përdorur burime të ndryshme mediatike për qëllime të caktuara.
4.5.12.C	Objektivat e linjës	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë tekste të mediave të shkruara ose jo të shkruara dhe elektronike për të zbuluar marrëdhëniet njerëzore, idetë e reja dhe aspektet kulturore; të identifikojë ndikime ekonomike dhe sociale në media të ndryshme; të diskutojë për ndikimet ekonomike dhe sociale në media të ndryshme; të identifikojë forma, teknika dhe teknologji të përdorura në mesazhe dhe paraqitje të ndryshme mediatike; të krijojë prezantime mediatike dhe raporte të shkruara që përdorin burime multimediatike me imazhe, grafikë, muzikë, efekte tingujsh, të cilat paraqesin një këndvështrim

		<p>të veçantë mbi një çështje;</p> <ul style="list-style-type: none">• të vlerësojë forma të ndryshme mediatike, p.sh.: televizionin, videon, lojërat, muzikën dhe filmin për përshtatshmërinë e mesazhit duke marrë parasysh audiencën, qëllimin e kontekstin;• të analizojë përmbajtjen e mesazheve mediatike për efektin emocional që ka tek vështuesi.
--	--	---